

URDHËR
Nr. 1, datë 9.1.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, Nëpunësit Autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.
2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Kuvendin e Shqipërisë.
 - 2.1 Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit, duke përfshirë procedurat e parashikuara në pikën 2.2 të këtij urdhri;
 - 2.2 Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, si dhe procedurat e ceremonialit zyrtar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.3 Në mungesë të znj. Albana Shtylla apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.1 të këtij urdhri, znj. Zeqo delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë;
 - 2.4. Në mungesë të znj. Etleva Zeqo apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave sipas pikës 2.2 të këtij urdhri, znj. Shtylla delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.
3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja e në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31.12.2017.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta